



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

ANEKSI NR. 1 B

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor Unlimited Surf+

	Unlimited Surf+
Pajtimi Mujor	1400 Leke/muaj
Internet me shpejtesi maksimale	40GB
Internet me shpejtesi te reduktuar (256 kbps)	Pa Limit

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
- 3) Pajtimi mujor dhe njësitë të përfshira në plan (MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.
- 4) Përllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 5) Interneti pas perfundimit të njësive do të jete me shpejtesi te reduktuar 256kbps.
- 6) Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
- 7) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerë e tarifën mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 8) Në rastet kur Pajtimtari ka përfutur një zbritje në çmimin e aparatit apo të një pajisje të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar më sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfutur në çmimin e aparatit.
- 9) Në rastet kur pajtimtari ka përfutur nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertes promovionale, dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmendura duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 10) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet vlerën e diferencës së pagesës fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 11) Në rastet kur Pajtimtari ka përfutur një zbritje në çmimin e aparatit apo të ndonjë pajisje të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të bejë ndryshim e planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar më sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfutur në çmimin e aparatit.
- 12) Në rastet kur pajtimtari ka përfutur nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, së bashku me detyrimet e sipërpërmendura duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 13) Në faturën e pare do të pasqyrohen detyrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen çdo 1 të muajit kalendarik. Në faturën mujore të lëshuar, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, sipas planit tarifor të zgjedhur.
- 14) ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (NSTAT), duke ju referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë të aplikojë këtë ndryshim jo më shumë se një herë në vit si dhe jo më vonë se 2 muaj pas publikimit të INSTAT.